



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 par.5 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin rrugor, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.21 e datës 13.06.2013 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në vazhdimin e seancës së datës 31. 10. 2014 me datë 06. 11. 2014 miratoi këtë

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E RREGULLORES
PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI
15Nr.011-27942 e datës 21.07.2014

Neni 1

Në nenin 4 të Rregullores paragrafi 7 fshihet.

Neni 2

Neni 6 – Konkursi publik i Rregullores, riformulohet dhe thekson:

“Neni 6
Njoftimi publik

Drejtoria për shërbime publike, do të publikojë Njoftimin publik për të njoftuar operatorët me obligimin për tu pajisë me Licencë për ushtrimin e veprimtarisë sipas kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore.”

Neni 3

Neni 5- Kushtet për licencim, par.1 pas nënparagrafit 1.5 riformulohet dhe thekson:

1.6 Operatori – personi juridik, të mos ketë të shqiptuar nga Gjykata masën e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë të transportit të udhëtarëve, dhe

1.7 Drejtuesi i automjetit personi fizik dhe i punësuar Te personi juridik të mos ketë të shqiptuar nga Gjykata masën e ndalimit të drejtimit të automjeteve.

Neni 4

Neni 7 - Dokumentacioni për licencim i Rregullores, fshihet.

Neni 5

Neni 8 - Shqyrtimi i aplikacioneve, riformulohet dhe thekson:

“Neni 8 – Shqyrtimi i kërkesave për lëshimin e Licencës

1. Kërkesat për lëshimin e Licencës me dokumentacionin në pajtim me nenin 5 të kësaj rregulloreje i parashtrihen Drejtoratit për shërbime publike.

2. Kërkesat i shqyrton Komisioni i formuar me Vendim të Drejtorit të Drejtoratit për shërbime publike brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën administrative.”

Neni 6

Neni 11 – Caktimi i vendparkingjeve, riformulohet dhe thekson:

“Neni 11

Dhënia në shfrytëzim e vendeve në vendparkingje

Vendet për qëndrimin e automjeteve taksi në vendparkingje, do tu jepen në shfrytëzim operatorëve të licencuar me vendime të Drejtoratit për shërbime publike.

Neni 7

Paragrafi 1 i nenit 22 - Veprimet kundravajtëse dhe lartësia e gjobave, plotësohet, si vijon:

1.1 në nënpar.1.1 në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: “veprim në kundërshtim me nenin 3.”

1.2 në nënpar.1.2 në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: “veprim në kundërshtim me nenin 3.”

1.3 në nënpar.1.3 në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: “veprim në kundërshtim me nenin 11.”

1.4 në nënpar.1.4 në vend të pikës vëhet presje dhe shtohen fjalët: “veprim në kundërshtim me nenin 4 .”

Neni 8

Në par.1 të nenit 24 - Afatet për nxjerrjen e akteve dhe veprimeve për zbatimin e Rregullores,
në vend të presjes së dytë vëhet pikë dhe teksti në vazhdim fshihet.

Neni 9

Neni 25 – Zgjidhja e kërkesave në procedurë, riformulohet dhe thekson:

“Kërkesat e pazgjidhura për dhënien e pëlqimeve për ushtrimin e veprimtarisë si dhe aplikacionet e pashqyrtuara të operatorëve për lëshimin e licencës sipas konkursit Nr.10-111-38806 të datës 22.09.2014, do të shqyrtohen konform dispozitave të kësaj Rregulloreje.”

Neni 10

Nenet 26 dhe 27 të Rregullores fshihen.

Neni 11

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. - 011-45598
Lipjan, më 12.11.2014

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajruni

